

**No. 54739\***

---

**Poland  
and  
Albania**

**Agreement on cultural and scientific cooperation between the Government of the Republic of Poland and the Government of the Republic of Albania. Warsaw, 4 May 1993**

**Entry into force:** *3 July 1993 by notification, in accordance with article 15*

**Authentic texts:** *Albanian, English and Polish*

**Registration with the Secretariat of the United Nations:** *Poland, 5 October 2017*

*\*No UNTS volume number has yet been determined for this record. The Text(s) reproduced below, if attached, are the authentic texts of the agreement /action attachment as submitted for registration and publication to the Secretariat. For ease of reference they were sequentially paginated. Translations, if attached, are not final and are provided for information only.*

---

**Pologne  
et  
Albanie**

**Accord de coopération culturelle et scientifique entre le Gouvernement de la République de Pologne et le Gouvernement de la République d'Albanie. Varsovie, 4 mai 1993**

**Entrée en vigueur :** *3 juillet 1993 par notification, conformément à l'article 15*

**Textes authentiques :** *albanais, anglais et polonais*

**Enregistrement auprès du Secrétariat de l'Organisation des Nations Unies :** *Pologne, 5 octobre 2017*

*\*Aucun numéro de volume n'a encore été attribué à ce dossier. Les textes disponibles qui sont reproduits ci-dessous sont les textes originaux de l'accord ou de l'action tels que soumis pour enregistrement. Par souci de clarté, leurs pages ont été numérotées. Les traductions qui accompagnent ces textes ne sont pas définitives et sont fournies uniquement à titre d'information.*

M A R R E V E S H J EPER BASHKEPUNIMIN KULTUROR E SHKENCOR NDERMJET QEVERISE  
SE REPUBLIKES SE POLONISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES  
SE SHQIPERISE

Qeveria e Republikës së Polonisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, me poshtë të quajtura "Palet Kontraktuese":

- Të nisura nga dëshira e përritjes së lidhjeve miqësore ndërmjet dy vendeve;
- Të bindura se bashkëpunimi kulturor e shkencor luan një rol të rëndësishëm në afrimin e shoqërive të të dy vendeve dhe në nxitjen e një paraqitjeje të gjithanshme të arritjeve të tyre;
- Duke synuar në realizimin e qëllimeve lidhur me dimensionin kulturor të parashikuar në Aktin Perfundimtar të Konferencës së Helsinkit, në Kartën e Parisit për një Evropë të re dhe në dokumenta të tjera të Konferencës mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë, përfshi dhe rregullimet e arritura në Simpoziumin e KSBE-së në Krakov mbi Trashëgimë Kulture:

Kanë arritur në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje dhe bien dakord për sa më poshtë:

NENI

Palet Kontraktuese do të përkrahin nismat dhe format e bashkëpunimit të gjithanshëm që ndërmerren nga shteti, institucionet publike dhe private, organizatat dhe shoqatat si dhe nga individët me synimin për të krijuar organizata dhe fondacione të përbashkëta Polako-Shqiptare, qëllimi i të cilave do të jetë materializimi i objektivave të kësaj Marrëveshjeje dhe çuarja drejt afrimit të ndërsjellitë të shoqërive të të dy vendeve.

NENI 2

Palet Kontraktuese do te fillojne kontaktet midis Komitetit Shteteror per Kerkimet Shkencore te Republikes se Polonise dhe Komitetit te Shkences dhe Teknologjise te Republikes se Shqiperise, me qellim qe te vendoset bashkepunimi i drejtperdrejte dhe te arrihet ne nenshkrimin e nje marreveshjeje nderqeveritare mbi bashkepunimin ne shkence dhe teknologji.

NENI 3

Palet Kontraktuese do te nxisin bashkepunimin ndermjet Akademise Polake te Shkencave dhe Akademise Shqiptare te Shkencave si dhe organizatave e institucioneve te tjere shkencore, qe do te realizohet mbi bazen e marreveshjeve perkatese qe do te perfundohen nga keto institucione. Palet do te ndihmojne ne menyre te ndersjellte studjuesit per realizimin e studimeve ne fushen e gjuhes, historise dhe historise se Polonise dhe Shqiperise. Kjo do te realizohet nepermjet:

- shkembimit te studjuesve;
- lehtesimit dhe publikimit te rezultateve te kerkimeve;
- organizimit te konferencave dhe ekspeditave shkencore te perbashketa;
- shkembimit te informacionit dhe dokumentacionit shkencor.

NENI 4

Ministria e Edukimit Kombetar e Republikes se Polonise dhe Ministria e Arsimit e Republikes se Shqiperise do te vendosin marredhenie te drejtperdrejta, me qellim qe te njihen me nivelet dhe sistemet e shkollave dhe arsimit te larte ne te dy vendet.

Palet do te nxisin dhe lehtesojne bashkepunimin e drejtperdrejte ndermjet universiteteve, shkollave

profesionale dhe institucioneve te tjera arsimore te te gjitha niveleve te te dy vendeve. Ne kete kuader ato do te perkrahin shkembimin e pedagogeve universitare, mesuesve, studenteve dhe nxenesve.

Palet do t'i afrojne njera-tjetres ne menyre te ndersjellte te drejta per studime universitare e pasuniversitare ne perputhje me parimet e miratuara nga te dy Palet.

#### NENI 5

Palet Kontraktuese do te inkurajojne dhe ndihmojne ndermarrjen e studimeve per gjuhen dhe letersine Polake ne Shqiperi dhe studimeve per gjuhen dhe letersine shqiptare ne Poloni.

#### NENI 6

Palet do te fillojne kontaktet e drejtperdrejta ndermjet Ministrise se Kultures dhe Arteve dhe Zyres per Edukimin Fizik dhe Turizmin te Republikes se Polonise dhe Ministrise se Kultures Rinise dhe Sporteve te Republikes se Shqiperise, me qellim qe te vendosin bashkepunimin ne fusha me interes te perbashket.

#### NENI 7

Palet Kontraktuese do te mbeshtesin interesin ne trashegimine kulturore dhe ne arritjet e sotme te Pales tjeter.

Palet Kontraktuese do te mbeshtesin veprimtarite qe ndermerren nga institucionet dhe organet qeveritare perkatese si dhe organizatat e institucionet joqeveritare, duke synuar afrimin e te dy vendeve, vecanerisht veprimtari te tilla si:

kontaktet e ndersjellta ndermjet institucioneve kulturore, shoqatave, bashkimeve, si dhe shoqatave te shkrintareve, perkthyesve, muzikanteve, kompozitoreve,

artisteve te teatrit e filmit,perfaqesuesve te arkeologjise, te ruajtjes se monumenteve te kultures, muzeve, bibliotekave, etj.;

-shkembimi i ekspozitave dhe veprimtari te tjera prezantuese me karakter arsimor ose informativ;

-perkthimi dhe botimi i literatures shkencore dhe i veprave artistike te krijuara nga autore te Pales tjeter;

-shkembimi i informacionit ne formen e botimeve, librave, revistave e gazetave si dhe permes mjeteve te tjera te informacionit duke perfshire edhe ato audiovizuale;

-pjesmarrjen e perfaqesuesve te seiciles Pale ne festivale, konkurse,parada dhe takime te tjera me karakter kulturor organizuar nga Pala tjeter Kontraktuese.

#### NENI 8

Per te lehtesuar propagandimin dhe popullarizimin e vlerave intelektuale dhe kulturore,seicila Pale Kontraktuese do t'u garantoje qytetareve te Pales tjeter, ne baze te konventave nderkombetare perkatese, mbrojtjen e te drejtave te autorit.

#### NENI 9

Palet Kontraktuese do te forcojne kontaktet ndermjet federatave sportive dhe institucioneve te tjera dhe do te stimulojne e mbeshtesin format e ndryshme te kontakteve dhe shkembimeve te te rinjve te te dy vendeve.

#### NENI 10

Per te siguruar nje informacion objektiv dhe te gjithanshem,Palet Kontraktuese,ne menyre te ndersjellte, do te perkrahin kalimin e lire te informacionit mbi jeten